REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 283/19
Datë/Datum. 18.06.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e Prokurimit: **KRU – Hidromorava sh.a** OE ankues: **"NAS SYSTEM " shpk**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP Nr.prot:283/19
Prej:	Basri Fazliu – Ekspert shqyrtues i prokurimit _____ Lavdim Fejza – Ekspert shqyrtues Teknik _____		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues-Teknik , lidhur me ankesën me Nr.283/19 të parashtruar nga OE **"NAS SYSTEM " shpk**–Gjilan		
Datë			

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e datës:05.06.2019, me nr. 238/19 të parashtruar nga OE **NAS SYSTEM " shpk** - Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me ujematësa zonal për Regjionin e Gjilan.Kamenice dhe Viti"me nr. Prok:18-8232-1-2-1**inicuar nga **AK-KRU "Hidromorava"** sh.a

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.
Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KRU –Hidromorava sh.a
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
  OE ankues - **NAS SYSTEM " shpk**

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

		11.06.2019	**17.06.2019**
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të ekspertit.*	*data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me Date:05.06.2019,OE NAS SYSTEM " shpk- Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP,kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "NAS systems sh.p.k-Gjilan, Furnizim me ujematësa zonal për Regjionin e Gjilan.Kamenice dhe Viti"me nr. Prok:18-8232-1-2-1 inicuar nga AK-KRU "Hidromorava" sh.a

Eksperti njofton panelin shqyrtues se kjo ankes eshte shqyrtuar paraprakisht nga ana e Panelit shqyrtues,

Ku eshte nxjerrur: Njoftimi nr.104.19 i dates 16.04.2019

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti teknik-shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë	25.10.2018
Lloji i procedurës së aplikuar	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar	Kontratë publike, Furnizim
Vlera e parashikuar e kontratës	35.000,00€
Kriteri për dhënie të kontratës(N.52)	tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave	08.11.2018
Data e mbarimit të vlerësimit ofertave	19.02.2019
Njoftimi mbi Vendimin e AK-së	19.02.2019
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar apo të pa suksesshëm	19.02.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim	25.02.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim (hera e 2-te)	28.02.2019
Njoftimi mbi Vendimin e AK-së	21.05.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim (hera e 3-te)	27.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim	05.06.2019

Kriteret për vlerësim

Kërkesat e përshtatshmërisë:

1.Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr 04 \ L-42. LPP i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 mund të shkarkohet nga http://krpp.rks-gov.net

2. Vertetim i nenshkruar nga Administrata tatimore e vendit tuaj te themelimit se nuk jeni ne vonese per pagimin e tatimeve se paku deri ne tre mujorin e fundit perpara dates se dorezimit te tenderit-Per kompanin fituse para nenshkrimit tekontrates

3.Dokument apo vertetim se nuk është me vonesene pagesen e taksave komunale

4. Dokument apo vertetim që nuk ka konteste gjyqsore ne Gjykaten Ekonomike

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Aneksi 2-Origjinal. Evidenca:2.Vërtetimi nga Administrata Tatimore ,për OE të rekomanduar për kontratë,para dhënies së kontratës.

Evidenca:3.Vertetim apo dokument nga Komuna se nuk ka borgje per taksa komunale,para dhenjes se kontrates, origjinali
Evidenca: 4, Vertetim apo dokument nga Gjykata ekonomike qe nuk eshte ne falimentim apo ne kontest gjyqsore. (nga gjyk.ekonomike)

Përshtatshmëria profesionale:
1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
2.Regjistrimi i TVSH (Çertifikata e TVSH)
3.Çertifikata e Numrit Fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
2.Regjistrimi i TVSH (Çertifikata e TVSH)
3.Çertifikata e Numrit Fiskal

Kapaciteti teknik dhe professional:
DOKUMENTET DËSHMUESE 1: Marrëveshje me Prodhuesin (ose me Distributor të Autorizuar)
DOKUMENTI DËSHMUES 2: Çertifikata e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001
Dokument deshmues 3) Certifikata OHSAS 18001 për Shëndetin Profesional dhe Menaxhimin e Sigurise për prodhimin e ujëmatësve.
Dokument deshmues 4) Certifikata për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor ISO 14001 për prodhimin e ujëmatësve.
Dokument deshmues 5) Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit ISO 27001 për prodhimin e moduleve RF të AMR për ujë

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Evidenca 1: Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë Marrëveshje me vetëm një prodhues specifik (ose distributor të autorizuar nga vetëm një prodhues specifik) për furnizimet e produketeve të kërkuara në teritorin e Kosovës.
Kjo Marrëveshje duhet të përmbajë:
(i) Emrin / kodin e produktit;
(ii) Detajet e kontaktit të adresës së prodhuesit dhe fabrikës.
- KOPJE
Evidenca 2.Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë një Çertifikatë të vlefshme dhe të verifikueshme për Menaxhim të Cilësisë ISO 9001.
- KOPJE
Evidenc 3) Opertori Ekonomiik duhet te dorezoj një Certifikat te vlefshme dhe te verifikushme per shednet dhe siguri per prodhim te ujit
Evidenca 4)pertori Ekonomiik duhet te dorezoj një Certifikat te vlefshme dhe te verifikushme per menaxhim mjedisor
Evidenca 5)Opertori Ekonomiik duhet te dorezoj një Certifikat te vlefshme dhe te verifikushme për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit ISO 27001 për prodhimin e moduleve RF të AMR

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatorët ekonomik	Vendi	Çmimi/€	Vërejtje
1.	"Nas systems" sh.p.k	Gjilan	28,841.00	JO
2.	"GO-X "sh.p.k dhe K-ING" sh.p.k	Prishtinë	31,869.00	JO
3.	Infra Group.ks&NN Infraplus	Prishtinë	29,036.94	JO
4.	NNT Tora com	Prishtinë	29,960.00€	JO
5.	Hidro Project shpk	Prishtinë	43,707.00€	JO
6	Hidro Mentori shpk	Prishtinë	35,035.21€	JO
7	KNTSH Teuta-M shpk	Gjilan	30,322.00€	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.
Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Afrim Muja– Kryetar i komisionit
- Kemur Mustafa– Anëtar i komisionit
- Begzad Muja – Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm sipas komisionit vlerësues:

Nr.	Emri i operatorëve ekonomik që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm	Vendi	Çmimi
1.	"Nas systems" sh.p.k	Gjilan	28,841.00
2	"GO-X "sh.p.k dhe K-ING" sh.p.k	Prishtinë	31,869.00

Komisioni pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, ka ardh në përfundim se OE ofertues "GO-X "sh.p.k dhe K-ING" sh.p.k Prishtinë është përgjegjshëm dhe të njëjtin e kanë rekomanduar për kontratë.
Rekomandimi i komisionit vlerësues është aprovuar nga Menaxheri i prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	X			Jo	

Kerkesa per rishqyrtim e dates 27.05.2019, por nuk kemi pranuar pergjigje ne asnje forme nga AK

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7

Neni 28

Neni 69

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Gjate qasjes ne dokumentacion ne kemi konstatuar se OE i përzgjedhur për kontratë është i papërgjegjshëm dhe dhënia e kontratës këtij OE është shkelje e të gjitha dispozitave të cekura

ne pozicionin nr 6:

OE i përzgjedhur nuk ka dorezuar specifikim teknik te detajuar por vetem katalogje, ku ka dorzuar katalogje te llojeve te ndryshme ,por pa specifikuar modelin e ofertuar, te cilat bie ndesh ne mes veti psh :per Ujematis me dimension DM 50 ka bashkangjitur dy katalogje me te njejtin model TK-7C por me specifika te ndyshme .

Duke ju referuar specifikave teknike te kerkuara " Pershkrimi i Ujmatesit zonal"

Ujëmatës zonal pulsativ i gatshëm për AMR, tip Woltmann, dizajn kompakt, i dedikuar për përdorim për matje të rrjedhjes me shumicë të ujit të ftohët të pijshëm, për nevoja komerciale dhe industriale dhe për monitorim të sistemit shpërndarës të ujit. Shtëpiza e ujëmatësit të jetë e mbrojtur me një shtresë ngjyrë epoxy. Ujëmatësit duhet të jenë në përputhje me të gjitha standardet relevante të kualitetit ISO 4064:2005).

OE i përzgjedhur nuk ka ofruar ujematesa te tipit Woltman per dimensionet e ujmatasave DN32 ,DN 40 dhe DN 50 por ka ofruar Multi jet Dry Type Water meter (model TK -26,TK- 5C dhe TK-7C) te cilet bie ndesh me kerkesat e AK dhe nuk i plotesojn specifikat teknike minimale te kerkuar.

Duke ju referuar specifikave teknike te kerkuara "Valvul Shiber"

Valvulat duhet të jenë të certifikuara sipas standadeve DIN- DVGW, të mbrojtura nga korozioni me shtresë (mbështjellës) të trashe të rrëshirës epoxy (min. 250 μm), i cili duhet të jetë konform me standardin DIN 3476 (P) dhe DIN 30677.

OE i përzgjedhur nuk ka ofruar valvula shiber konform me standardin DIN 3476 (P) dhe DIN 30677 ,edhe kjo bie ndesh me kerkesat e AK dhe nuk i plotesojn specifikat teknike minimale te kerkuar, po ashtu nuk ka ofruar valvula per dimensioni DN 32 siq janë kerkuar

Me këtë konstatojmë se është shkelur neni 7,28 dhe 69 i LPP-së

Andaj kërkojmë nga ju si institucion që të bëni vlerësimin e këtyre faktëve dhe konstatoni shkeljet e lartëpërmendura dhe të urdhëroni AK të veprojë në kuadër të dispozitave ligjore të parapara me LPP.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Nas systems" sh.p.k

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin OE ankues se OE i rekomanduar per kontrat sa i perket ujëmatësve :
-Ujëmatësi zonal pulsativ i gatëshem për AMR,tip Woltman, dizajn kompakt , i dedikuar per matje të rrjedhjes me shumicë të ujit të ftofte të pijshëm të kerkuar në FTD dhe ne specifikim teknik të detyrueshëm.
Ujematësi zonal duhet të jete i pajisur me njësin për dhënie të pulseve (pulse output unit) dhe me veqori për lexim autmomatik të hargjimit, ujematsi duhet të ketë shenje CE si shenje e konfirmitetit te BE si dhe shenjen plotsuese M si shenje e metrologjis.

Eksperti teknik, lidhur me pretendimin OE ankues, sqaron se pas ekzaminimit te dosjes se tenderit dhe specifikave teknike te kërkuara vlerëson se OE i rekomanduar për kontratë GO-X "sh.p.k dhe K-ING" sh.p.k i ka permbushe specifikim teknik te detyrueshëm për ujemates të cilat janë në FTD.
O.E i rekomanduar për kontratë ka aplikuar me ujematese te mdelit: tip Woltman, katalogun te cilin e ka prezantue O.E i rekomanduar për kontratë shihet qartë se ujematsi e ka shenjen "CE" si shenje e konfirmitetit te BE si dhe shenjen plotësuese "M" si shenje e metrologjisë, po ashtu nuk verehet numri serike i ujematesit qe indetifikone ujematsin.Po ashtu OE i rekomanduar për kontratë i ka te paraqitura të gjithë ujematesit të paraqitur në kataloget të cilat i ka të prezantuara sipas kerkeses të kerkuar ne DT.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Përgjigjet ne pretendimet ankimore qe OE ankues, ne lidhje me ofertën e OE te rekomanduar për kontratë te cilat nuk i ka plostsur specifika teknike te detyrushme per Valvola Shiber te cilat janë kerkuar ne DT nga AK-ja, me rastin e parashtrimit .

Eksperti teknik, lidhur me pretendimin e OE ankues se AK-ja, nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 59 konkretisht (nenit 28 specifikimin teknik) të LPP-së, me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontrate ka prezantuar valvolat shiber sipas standartit :EN 558 po është dashtur të prezantoje sipas standartit DIN 3476 dhe DIN 30677 të kerkura ne DT se nuk janë të njeta .Kjo nuk qëndrone sepse keto dy standarte EN dhe DIN nderlidhen ne mes vete.

PN 10-16 DN 40-400
EN 558-1
• Prodhuar sipas kërkesave të EN 1074 dhe EN 1171 .
• Certifikuar dhe e shënuar nga trupi i tretë si prodhim mbikëqyrësi.
• EPOXY pluhur me cilësi të lartë të trupit dhe mbulesës së veshur (bashkim i ngjitur), trashësia e veshjes DFT(Desing For Testing) min. **250 mikron**, porozitet zero (testuar me 3000V), ndikim të lartë rezistencë dhe **ndërlidhje sipas standardit DIN 30677-2 dhe DIN 3476.**
OE i rekomanduar per kontrate ka prenazuar valvola sipas kerekese se Ak-se ne DT.

Mendimi i ekspertit shqyrtues-Teknik:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti shqyrtues-teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues është e pa bazuar, dhe të mbeten ne fuqi vendimi i AK njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues për dhënie të kontratës .